

Naile Mala-Imami
Fakulteti Filologjik
Universiteti i Beogradit

Shkollat në gjuhën shqipe në Kosovë dhe në jug të Serbisë (1945-2015)

Abstrakt:

Ky punim ka për qëllim të japë një pasqyrë historike të zhvillimit të shkollave (1945-2015) në gjuhën shqipe në Kosovë dhe në Jug të Serbisë, në zonën e Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës. Pas Luftës së Dytë Botërore, me vendosjen e marrëdhënieve shoqëroro-ekonomike socialiste, janë korrigjuar padrejtësitë historike ndaj popullit shqiptar në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve/të Jugosllavisë, kur populli shqiptar nuk ka pasur të drejtë të shkollohej në gjuhë amtare. Nga viti në vit, edhe përkundër problemeve të shumta, vazhdimisht ka filluar të zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe në shkolla fillore dhe të mesme, kurse në vitin 1960 u vunë themelet edhe në arsimin universitar. Zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe në Kosovë në të gjitha nivelet deri në vitin 1990, edhe përkundër kufizimeve ideologjike dhe politike, ka patur rezultate të dukshme në shkollimin e brezave të rinj të kombit shqiptar. Pas vitit 1999 Kosova krijoi sistemin e shkollave të veta, kurse shqiptarët në jug të Serbisë kanë realizuar pjesërisht të drejtën për trajtimin e temave kombëtare.

Fjalë kyçe:

arsimi në gjuhën shqipe, Kosova, jugu i Serbisë, Serbia, politika arsimore

1. Shkollat në gjuhën shqipe në Kosovë (1945-2015)

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë dhe në viset e tjera të Jugosllavisë, rregullimi socialist shtetëror bëri të mundur edhe shkollimin për popullsinë shqiptare, gjë që ka qenë plotësisht e pamundur gjatë Mbretërisë SKS/Jugosllavisë. Me kërkesë të komisarit për arsim në Kosovë, Mita Milkoviqit (Milković), Shqipëria në vitin 1945 dërgoi menjëherë 20 000 kopje të abetareve *Këndimi im i parë*, e pastaj edhe librat e tjerë shkollorë. U dërguan gjithashtu edhe 100 mësues dhe arsimtarë për arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë (Berisha, 1994, 32-34).

Deri në vitin shkollor 1954-55, në Kosovë shkollat e hapura fillore dhe të mesme organizoheshin sipas parimit kombëtar. Në vitin shkollor 1944-45 ishin 278 shkolla fillore deri në klasën e katërt në Kosovë, në të cilat mësimin në gjuhën shqipe e vijonin 11573 nxënës, kurse 15427 në gjuhën serbe. Në vitin shkollor 1951/52 ishin 517 shkolla fillore (4-vjeçare) me mësim në gjuhën shqipe, 305 në gjuhën serbe dhe katër në gjuhën turke, pastaj tetë shkolla fillore 8-vjeçare të përziera me nxënës shqiptarë dhe serbë, katër gjimnaze të plota dhe 465 gjimnaze të nivelit të ulët me mësimin në gjuhën shqipe dhe 83 në gjuhën serbe, si edhe 10 shkolla profesionale me mësimin në gjuhën serbe dhe dy (shkolla normale) në të cilat mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe (Stojković, Martić, 1953, 146-147).

Në vitin shkollor 1958/59 gjithsej ishin 582 shkolla fillore 4-vjeçare, 35 shkolla 6-vjeçare dhe shtatëvjeçare dhe 116 shkolla fillore 8-vjeçare. Në to ishin të regjistruar 86195 nxënës në paralelet në gjuhën shqipe, 47550 në paralelet në gjuhën serbe dhe 3404 në paralelet në gjuhën turke. Në shkolla të mesme mësimin në gjuhën shqipe e vijonin 3216 nxënës, në gjuhën serbe 4770, kurse në gjuhën turke 124. Në atë kohë kuadrot e ardhshme për arsim në gjuhën shqipe u formuan në dy shkolla normale, në Prishtinë dhe në Gjakovë.

Një kthesë në politikën ndaj kombësisë shqiptare në Jugosllavi sollën Përfundimet e Komitetit Ekzekutiv të KQ të PKJ për çështje të pakicave kombëtare (02.03.1959), në të cilat thuhet se pakicat kombëtare janë pjesë përbërëse e bashkësisë socialiste jugosllave dhe se në fushën e arsimit të pakicave është i nevojshëm aftësimi i rrjetit të shkollave, me qëllim që t'i përfshijë në mënyrë sa më të plotë edhe nxënësit nga radhët e pakicave kombëtare. Përfundimet iu dërguan organizatave themelore të PKS, por me to është njohur edhe opinioni i gjerë më 28 qershor të vitit 1962 në gazetën *Komunist* (Imami, 2000).

Ndryshimet pozitive në arsimin në gjuhën shqipe janë krijuar në fillim të viteve 60-të. Enti për Botimin e Teksteve Mësimore në Beograd në vitin 1963 botoi librat e shkrimtarëve shqiptarë (Naim Frashëri, Fan Noli, Migjeni, Ndre Mjeda, Andon Zako Çajupi, Kristo Floqi dhe etj.), çka u mundësoi nxënësve shqiptarë në Kosovë që të njihen me letërsinë e vet kombëtare. Në kuadër të programeve mësimore të shkollave në Serbi janë bërë plotësimet për historinë shqiptare (Imami, 2000).

Një numër i madh i kuadrove më të mirë në mesin e shqiptarëve është shkolluar gjatë viteve 50-të dhe 60-të në Universitetin e Beogradit, të cilët më vonë njohuritë i kanë përcjellë edhe në mësimin në gjuhën shqipe në të gjitha nivelet e shkollimit në

Kosovë. Bashkë me ndihmën me kuadro të Universitetit të Beogradit, në Prishtinë në vitin 1960, u themelua Fakulteti Filozofik. Me hapjen edhe të disa fakulteteve, në fillim të vitit 1970 është themeluar Universiteti në Prishtinë, me katër fakultete dhe pesë shkolla të larta. Po atë vit në këtë universitet janë regjistruar 10368 studentë, 5707 në gjuhën shqipe dhe 3916 në gjuhën serbe.

Në vitin shkollor 1970/71 numri i shkollave fillore arriti në 824, e në to mësimin në gjuhën shqipe e kanë ndjekur 177197 nxënës, në gjuhën serbe 61923 nxënës, kurse në gjuhën turke 2413 nxënës. Shkolla të mesme gjithsej kanë qenë 69, me 24667 nxënës në paralelet në gjuhën shqipe, 16891, në paralelet në gjuhën serbe dhe 613 në paralelet në gjuhën turke (Kosova dikur dhe sot, 1973, 554).

Mirëpo, pas shpërthimit të krizës politike në Kosovë në vitin 1981, ndaj një numri të arsimitarëve dhe të nxënësve u ndërmorën masa mjaft të ashpra. U ndryshuan programet mësimore dhe librat shkollorë në gjuhën shqipe. U ndalua përdorimi i librave shkollorë dhe i tre doracakëve për mësimin fillor dhe të mesëm, i 10 librave për nivelin universitar dhe i 20 librave me literaturë ndihmëse. Nga librat e leximit në gjuhën dhe letërsinë shqipe për shkolla fillore dhe të mesme u hoqën 35 përmbajtje. Menjëherë nga shkollat fillore dhe të mesme janë larguar 298 arsimitarë dhe 1015 nxënës, kurse nga Universiteti i Prishtinës 14 profesorë dhe 179 studentë (Beqaj, B., 1988, 604-607). Në periudhën nga viti 1981 deri në vitin 1989 nga shkollat e mesme janë larguar 1051 nxënës, nga universiteti janë larguar 568 nxënës dhe gjithsej 388 mësimdhënës në të gjitha nivelet e arsimit (Hyseni, 2000).

Mësimi jashtë sistemit shtetëror të Republikës së Serbisë

Kur mësimi në gjuhën shqipe në Kosovë në vitin 1989 u vu jashtë ligjit, në shkolla fillore kanë qenë të regjistruar 304836 nxënës, kurse në shkolla të mesme 71257 prej tyre. Nxënësit shqiptarë më nuk kanë pasur leje që të përdornin ndërtesat në 35 shkolla fillore dhe 60 shkolla të mesme, kurse në ato shkolla ku mësimi mund të zhvillohej, ai mbahej vetëm pasdite, pas orës 14.00 dhe këtë vetëm në klasa, kurse ambientet e tjera hapësinore dhe mjetet mësimore nuk kanë mundur t'i përdorin. Edhe në fakultete është suprimuar mësimi në gjuhën shqipe.

Sërgjan Bogosavleviq (Srđan Bogosavljević), ekspert për demografi, thekson faktin brengosës se duke filluar nga viti shkollor 1989/90, shkollat në gjuhën shqipe praktikisht filluan të zhduken, sepse numri i nxënësve mezi e tejkalonte numrin prej shtatëmbëdhjetë mijëve. „Paralelisht u zvogëluar edhe numri i arsimitarëve, kurse numri i shkollave fillore ra nga 943 në 110 shkolla, ndërsa numri i shkollave të mesme nga 72 në 6. U zhvillua një sistem alternativ i shkollave, i cili e plotësoi zbrazëtirën e krijuar, por për të nuk ka të dhëna zyrtare. Mirëpo edhe vetë fakti se arsimitarët është mbajtur në ambiente jashtë shkollave tregon se sa probleme janë krijuar në relacionin midis serbëve dhe shqiptarëve, e që nuk janë zgjidhur“ (Sukob ili dialog, 1994, 27).

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë socialiste dhe suprimimit të autonomisë relative të Kosovës, pushteti i Republikës së Serbisë u imponoi shqiptarëve në Kosovë një

numër të madh të „masave të përkohshme“: „Në arsim nxënësve shqiptarë iu imponua kurrikula serbe; kur arsimtarët protestonin, ata i largonin nga puna, numri i fëmijëve të cilët mund të vijonin mësimin në gjuhën shqipe u zvogëlua dhe me ndihmën e policisë nxënësit dhe arsimtarët pengoheshin që të hyjnë në shkolla. Politika e 'nacionalizimit' vazhdoi dhe kështu nga 36000 nxënës shqiptarë të cilët mbaruan shkollën fillore në vitin 1991, për ta ishin të rezervuara vetëm 6000 vende për regjistrim në shkolla të mesme (për të gjithë nxënësit serbë dhe malazezë ka pasur vende). Mbi 860 anëtarë të personelit mësimor u larguan nga Universiteti i Prishtinës, kështu që në brendi ky institucion u bë institucion thjesht serb“ (Tematski izveštaj, 2001, 13)¹³⁴

Kur është fjala për bibliotekat e shkollave, në vitin 1986 kanë ekzistuar 367, me 1231000 libra, kurse ky numër në vitin 1995, siç dëshmon revista *Vjetarët* e Entit për Statistikë të Republikës së Serbisë, është zvogëluar në gjithsej 144, me gjithsej 578000 libra. Në krahasim me vitin 1986 në biblioteka të Kosovës kanë qenë 653000 libra më pak! (Vjetari për statistikë i Serbisë, 1986, 1995)

Analisti Dushan Janjiqi (Dušan Janjić) thekson se në kontekstin e një politike të këtyrë u miratuan ligje të shumta, në mesin e të cilëve edhe Ligji për veprimin e organeve republikane në rrethana të veçanta (1990). Vijoi mbyllja e shkollave, dëbimi i arsimtarëve nga puna dhe kufizimi i regjistrimit në shkolla në gjuhën shqipe; u ndërpre financimi i atyre shkollave të cilat „nuk i përmbaheshin programit unik arsimor për Serbinë“, etj. Siç thekson Janjiqi, si pasojë e kësaj rreth 250000 nxënës shqiptarë nuk kanë pasur mundësi që të vazhdojnë shkollimin e rregullt. Në shkolla të mesme në vitin 1991 kanë mundur të regjistrohen gjithsej 28,8% nxënës. Është mbyllur një numër shkollash fillore dhe të mesme dhe u vendos segregacioni sipas bazës nacionale (Janjić, 1994, 148-149).

Në një situatë të këtyrë, në periudhën nga viti 1992 deri në vitin 1998 mësimi në gjuhën shqipe, në të gjitha nivelet, ka qenë i vetëorganizuar jashtë sistemit shkollor të Republikës së Serbisë. Në *Raportin tematik për politikën kombëtare të arsimit në Kosovë*, të Paktit të Stabilitetit për Evropë Juglindore, më 22 qershor të vitit 2001, pohohet: „Të hollat për paga të arsimtarëve janë siguruar nga 3% 'tatimi mbi të ardhurat' të cilat i ka grumbulluar pushteti tatimor i 'qeverisë në hije' sa kanë mundur nga sindikata dhe nga diaspora e shqiptarëve të Kosovës. Fondi shtetëror i Republikës së Kosovës në hije, i ka grumbulluar donacionet gati në të gjitha shtetet perëndimore dhe e ka realizuar gati 30% të buxhetit shtetëror në hije. Shkollat 'paralele', edhe pse deri diku janë toleruar nga ana e pushtetit serb, kanë qenë objekt i represionit dhe i kërcënimeve. Cilësia e arsimit patjetër që ra, por edhe numri u zvogëlua, sidomos te vajzat. Deri në vitin 1996, regjistrimi në shkolla fillore ka rënë 12%, në shkolla të mesme 21%, kurse regjistrimi në fakultete përgjysmë.

¹³⁴ Për shkak se nuk ka ekzistuar mundësia që të shikohet faqja zyrtare në gjuhën serbe, i drejtojmë lexuesit që ta vizitojnë faqen zyrtare në gjuhën angleze: *Thematic Review of National Policies For Education – Kosovo*. 22.06.2001. Pact for South Eastern Europe. [http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=CCNM/DEELSA/ED\(2001\)6&docLanguage=En](http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=CCNM/DEELSA/ED(2001)6&docLanguage=En)

Librat kanë qenë problem kronik, sidomos librat shkollorë për nxënës të klasave më të larta ose për studentët e mjekësisë“. Diplomat e shkollës kanë pasur vulat „Republika e Kosovës“ (Tematski izveštaj, 2001, 8).

Mësimin në gjuhën shqipe në sistemin „paralel“ të arsimit e kanë vijuar në vitin 1998, 266400 nxënës në shkollat fillore, 58700 në shkollat e mesme dhe 16000 studentë. Kur në prill të atij viti shpërtheu konflikti i armatosur në Kosovë, rreth 95000 fëmijë e ndërprejnë mësimin. Përndryshe, vlerësohet që në periudhën e përmendur mësimin e kanë vijuar rreth 80% të fëmijëve të grup-moshës 7–15 vjeçare dhe vetëm rreth 38% të grup-moshës 16–18 vjeçare (Tematski izveštaj, 2001, 9).

Nën presionin e Bashkësisë Ndërkombëtare dhe me ndërmjetësimin e Organizatës Humanitare Katolike Shën Egidio (St. Egidio), të cilën e përfaqësonte monsinjor Vinçenc Pala, presidenti i Jugosllavisë, Slobodan Milosheviqi dhe dr. Ibrahim Rugova, pa i theksuar funksionet e tyre dhe pa u takuar, më 1 shtator të vitit 1996 nënshkruan marrëveshjen e pakushtëzuar për kthimin e nxënësve dhe të studentëve shqiptarë në objektet e shkollave në Kosovë, por çështjet për programet e mësimin mbetën të hapura. Pas një zvarritjeje të gjatë, në Prishtinë, më 23 mars të vitit 1998, u nënshkrua marrëveshja për arsim në Kosovë nga ministri për Kosovë në Qeverinë e Serbisë, Ratomir Vico dhe ish-këshilltari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Fehmi Agani. Kjo marrëveshje parashikonte kthimin gradual të nxënësve shqiptarë në ndërtesa të shkollave dhe të fakulteteve deri më 30 qershor të vitit 1998, gjë që në praktikë u realizua pjesërisht vetëm për mësimin në fakultete dhe gati nuk është zbatuar fare për arsimin fillor dhe të mesëm.

Mësimi nën patronatin e misionit civil të Kombeve të Bashkuara – UNMIK-ut

Me ardhjen e forcave ndërkombëtare të sigurisë (KFOR-it) dhe me vendosjen e administratës së përkohshme të KB në Kosovë (UNMIK-u) në qershor të vitit 1999, u krijuan rrethana të reja për zhvillimin e arsimit në Kosovë. Edhe pse me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit është parashikuar shoqëria shumë etnike në Kosovë, në fakt vetëm një numër i shkollave ka pasur karakter shumë-etnik, por edhe ato kanë punuar në turne të ndara.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 1999, popullsia në Kosovë shumë shpejt u nda në baza etnike dhe në të njëjtën kohë edhe shkollat u ndanë sipas përbërjes kombëtare dhe territorit. Në shkolla fillore me mësim në gjuhën shqipe, në 1999/2000 janë regjistruar 265374 nxënës, në shkolla të mesme 73.961, kurse në shkolla të larta 22058 studentë (Hyseni, 2000). Sistemi i ri arsimor u vendos në shtator të vitit 2000, sipas direktivës së UNMIK-ut nr. 2000/51, me të cilën përcaktohet që arsimi i obligueshëm fillon nga mosha gjashtë vjeçare.


Në një pasqyrim skematik struktura e sistemit të përgjithshëm arsimor në Kosovë nga shtatori i vitit 2001 përfshin:

- arsimin fillor, 5 klasë,
- arsimin e ulët të mesëm, 4 klasë,
- arsimin e mesëm të lartë, 3-4 klasë,
- provimin pranues për regjistrim në shkolla të mesme të larta (profesionale dhe të përgjithshme),
- provimin përfundimtar pas klasës së 3-të të shkollës së mesme profesionale,
- provimin e maturës pas klasës së 13-të,
- provimin pranues për regjistrim në universitet.

Arsimi themelor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë është falas. Vetëm gjatë nivelit fillor të arsimit nxënësit i marrin librat shkollorë falas (Ligji nr. 2002/2).

Në raportin tematik të Paktit për Stabilitet për Evropë Juglindore për arsimin në Kosovë pohohet se sistemi arsimor, të cilin Kosova e ka trashëguar nga e kaluara është mjaft „i ngurtë në metoda të mësimdhënies“, gjë që edhe më tutje ka ndikuar negativisht „në cilësinë e mësimin dhe në procesin arsimor në tërësi“. Pohohet që për shkak të izolimit gjatë dhjetëvjetëshit të fundit, „sistemi arsimor në Kosovë nuk ka mundur t’i përballojë disa ndryshime kryesore në arsim (sidomos në fushën e didaktikës, praktikës mësimore, pedagogjisë), të cilat janë zhvilluar në vendet antërare të OSBE-së ose në disa ish-shtete komuniste të Evropës Qendrore... Mësimi kryesisht është autoritar frontal ose i drejtpërdrejtë; është mbizotërues modeli i arsimit si personalitet qendror. Mësimi teorik është i zakonshëm, duke u kushtuar pak vëmendje teknikave të zbulimit dhe punës në grup, shqyrtimeve, zgjidhjeve të problemeve, hartimit të projekteve, bërjes së portfolios. Arsimtarët përdorin metodën e ligjërimit, kurse nxënësit e mbajnë mend/memorizojnë materialin. Përfundimisht gjenden kryesisht në programet eksperimentale të cilat i kanë vendosur organizatat e ndryshme joqeveritare në disa shkolla, si edhe një numër i nismave vendore“ (Tematski izveštaj, 2001, 16).


Tabela 1. Numri i nxënësve në arsimin fillor nga viti 2002/2003 dhe 2007/2008.



Burimi: Enti për Statistikë i Kosovës, http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com_content&view=article&id=105&Itemid=91 [Vizituar më: 05.02.2010]

Zvogëlimi i numrit të nxënësve në vitin shkollor 2004/2005 shpjegon faktin se gjatë periudhës nga viti 2003/2004 nuk kanë qenë të përfshira të dhënat për numrin e nxënësve të cilët kanë mësuar në gjuhën serbe, kurse shkaku tjetër është zvogëlimi i numrit të nxënësve për shkak të numrit më të vogël të lindjes së fëmijëve gjatë vitit 1999.

Tabela. 2 Numri i fëmijëve në arsimin e mesëm nga viti 2002/2003 dhe 2007/2008.



Burimi: Enti për Statistikë i Kosovës, http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com_content&view=article&id=105&Itemid=91 [Vizituar më: 05.02.2010]

Në vitin shkollor 2014/2015 në Kosovë kanë qenë gjithsej 1153 shkolla shtetërore, nga këto 43 parashkollore (36 paralele amë dhe 7 paralele të jashtme), 985 fillore dhe shkolla të mesme të ulëta (633 paralele amë dhe 352 paralele të jashtme), 119 të mesme (103 amë dhe 16 paralele të jashtme) dhe 6 profesionale (pa paralele të jashtme). Këtë vit shkollor janë regjistruar 388351 nxënës, në të cilët hyjnë 20875 në mësim parashkollor, 275887 në shkollat fillore dhe shkollat e mesme të ulëta, ndërsa 86219 në shkollën e mesme. Sipas përkatësisë etnike numri i nxënësve të cilët e përcjellin mësimin në gjuhën shqipe është: shqiptarë 372794, boshnjakë 4351, romë 1918, egjiptianë 772, ashkalinj 4177, turq 2.850, goranë 676, kroatë 31, serbë sipas të dhënave jo të plota janë 622, si dhe 160 të tjerë (Statistikat e arsimit, 2013-1024).

Nxënësit e kombësisë serbe dhe shumica e kombësisë rome dhe gorane edhe më tutje mësojnë sipas planit dhe programit të Qeverisë së Serbisë, në kompetenca të së cilës gjenden edhe shkollat. Nxënësit e përkatësisë turke dhe boshnjake janë të integruar plotësisht në sistemin arsimor të Kosovës. Ata e vijnë mësimin në gjuhët e veta, me plane dhe programe të Qeverisë së Kosovës. As në shkolla të Kosovës as në institucione paralele të Qeverisë së Serbisë mësimi nuk është organizuar në gjuhën rome, por në Serbi romët në shkolla fillore e kanë gjuhën rome si lëndë fakultative (Bashkësitë etnike 2007 dhe 2008, 163).

2. Shkollat në gjuhën shqipe në jug të Serbisë (1945-2015)

Pakica kombëtare shqiptare në rajonin e Preshevës, Bujanocit dhe të Medvegjës jeton në tri komuna në jug të Serbisë, nga të cilat në dy janë popullsi shumicë, në Preshevë dhe në Bujanoc dhe relativisht një numër i vogël në Medvegjë. Sipas regjistrimit në vitin 2002, në Serbinë Qendrore jetojnë 59985 pjesëtarë të kombësisë shqiptare, gjë që e përbën 1.10% të popullsisë së Serbisë. Gjuha shqipe dhe alfabeti janë në përdorim zyrtar në Preshevë, Bujanoc dhe në Medvegjë.

Shkolla e parë fillore në atë trevë me mësim në gjuhën shqipe është hapur në Preshevë më 7 shkurt të vitit 1945, në shtëpinë të cilën e ka dhuruar banori i këtij fshati Abdullah Veliu, e njohur si „Villa Letafet“, ndërsa mësuesit e parë kanë qenë Hilmi Qerimi, Abdulla Ukshini, Tajar Zulfu nga Elbasani dhe Demirali Ramadani (Emini, 2014, 115). Gjatë vitit shkollor 1951/52 mësimi është mbajtur në 36 shkolla të ulëta fillore dhe në dy shkolla 8-vjeçare në komunën e Preshevës dhe të Bujanocit. Në Medvegjë shkolla e parë fillore e nivelit të ulët në gjuhën shqipe u hap më vonë, në vitin 1967. Shkolla e parë e mesme me mësim në gjuhën shqipe në Preshevë u hap në vitin 1961, kurse dhjetë vjet më vonë edhe në Bujanoc. Në Medvegjë në vitin shkollor 2008/2009 ka diplomuar gjenerata e parë e cila e ka vijuar mësimin në gjuhën shqipe, në degën e ekonomisë në shkollën e mesme teknike „Nikola Tesla“, në të cilën deri atëherë mësimi është mbajtur vetëm në gjuhën serbe.

Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Serbisë ndaj pakicave

Në pikëpamje të dokumenteve ndërkombëtare, Serbia ka trashëguar të gjitha ato detyrime ndërkombëtare të cilat i ka aprovuar Jugosllavia socialiste: Dokumentin përfundimtar të Konferencës së Vjenës të vitit 1989, Kartën e Parisit të vitit 1990, Përfundimet nga Tubimi i Ekspertëve për të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare në Gjenevë në vitin 1991 dhe Dokumentin e Helsinkit të OSBE nga viti 1992. Në komentet e këtyre dokumenteve është theksuar se në to „theksi është vënë në individ“ kur flitet për pjesëtarët e pakicave kombëtare dhe etnike, fetare ose gjuhësore, si edhe që të gjitha të drejtat „kanë të bëjnë vetëm me individët kurse të drejtat kolektive të pakicave kombëtare nuk përmenden fare“. Është theksuar që „në të gjitha dokumentet e OSBE-së dhe të OKB-së ekziston zëri i qartë për obligimet e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për lojalitet ndaj shtetit në të cilin jetojnë“ edhe kur është fjala për format e autonomisë për pjesëtarë të pakicave kombëtare „askund nuk thuhet asnjë fjalë për autonomi territoriale“. Kjo gjë ishte theksuar në faqen zyrtare të Ministrisë Federale për Punë të Jashtme, në një tekst me titull: Pakica Kombëtare Shqiptare dhe standardet ndërkombëtare, por ndërkohë ky tekst është hequr nga web faja.

Pas ndryshimeve demokratike, Serbia ka pranuar shumë akte ndërkombëtare me të cilat rregullohen të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave. Parlamenti i Serbisë në vitin 2005 ka ratifikuar *Kartën Evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave*, e cila sot është juridikisht e obligueshme në Serbi. Në të, në nenin 7, kërkohet „respektimi

i zonave gjeografike të secilës gjuhë rajonale ose të pakicave“, në nenin 8, insistohet në këtë që në „pikëpamje të arsimit shtetet e marrin obligimin“, që duhet të krijohen paketa propozimet/zgjidhjesh të cilat do të siguronin mësimin e historisë dhe të kulturës, e cila ka të bëjë me gjuhët rajonale ose të pakicave (*Ligji për ratifikim*).

Kushtetuta dhe Ligjet e Republikës së Serbisë për arsimimin e pakicave

Me Kushtetutë të Republikës së Serbisë, nga viti 2006 janë rregulluar përveç të drejtave të tjera edhe „e drejta për të qenët i ndryshëm, e drejta për ruajtjen e veçantisë, të drejtat kolektive të pakicave kombëtare (informimi, kultura, arsimit, përdorimi zyrtar i gjuhës) dhe e drejta për vetëqeverisje“ (*Gojković, 5*). *Me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare*, nga viti 2002 është rregulluar statusi i pakicave kombëtare. Nevena Gojković pohon që me këtë ligj realizohen të drejtat kolektive të pakicave kombëtare përmes autonomisë kulturore. „Brendia e *autonomisë kulturore* është e drejta për ruajtjen e veçantisë dhe mbrojtja e identitetit të tyre kolektiv, përmes së cilës garantohet e drejta për përdorimin e gjuhës dhe të alfabetit, shkollimi në gjuhë amtare, e drejta për përdorimin e emrave dhe të mbiemrave, themelimi i institucioneve private arsimore, informimi etj. [...] Pra, brendinë e autonomisë kulturore e përbëjnë: e drejta për përdorim zyrtar të gjuhës (nëse në komunë jetojnë më shumë se 15% e popullsisë e cila i takon një pakice kombëtare), arsimit, kultura dhe informimi“ (po aty, 7). *Me Ligjin për bazat e sistemit të arsimit dhe të edukimit* nga viti 2004, është rregulluar që pjesëtarët e pakicave kombëtare mund të arsimohen në gjuhë të vet ose në dy gjuhë, se mbajtja e mësimin në gjuhë amtare është e nevojshme që në një klasë të regjistrohen jo më pak se 15 nxënës, por është e mundur edhe që me lejen e ministrit të arsimit ky numër të jetë edhe më i vogël. Bashkë me mësimin e gjuhës amtare është i obligueshëm edhe mësimi i gjuhës serbe, kurse në rastin kur pjesëtari i pakicës kombëtare vendos ta vijojë mësimin në gjuhën serbe, shkolla duhet ta sigurojë edhe mësimin në gjuhën amtare me elementet e kulturës kombëtare. (po aty, 9). Më në fund, me *Ligjin për Vetëqeverisjen vendore* nga viti 2002, me ndryshimet nga viti 2006 dhe 2007 është rregulluar që në nivel lokal të kihet kujdes për të drejtat e pakicave kombëtare që kanë të bëjnë me themelimin dhe punën e institucioneve arsimore, mbrojtjen e të mirave kulturore, sigurimin e informimit publik, vendosjen e gjuhës dhe të alfabetit në komunikim publik, si edhe punën e bibliotekave, muzeve dhe të institucioneve të tjera të kulturës (po aty,10).

Problemet shoqëroro-politike lidhur me mësimin në gjuhën shqipe në jug të Serbisë

Dëbimi nga puna i profesorëve dhe format e tjera të përjashtimit nga puna në vitin 1989 bëjnë pjesë në shkeljet e para të drejtave për punë dhe të të drejtave të pakicave për arsim në gjuhën amtare. Një numër i profesorëve të shquar të kombësisë shqiptare u dëbuan nga Qendra për arsim në Preshevë, kur ky institucion u shpall

„çerdhe e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar“. Fondi për të Drejtën Humanitare shkruan, se në mesin e problemeve me të cilat po ballafaqohen pakicat në arsim janë objektet jo të përshtatshme të arsimit, mungesa e mjeteve shkollore, planet dhe programet mësimore joadekuate, mosnjohja e diplomave të fituara në Kosovë gjatë periudhës 1991-2001 dhe pamundësia e ndikimit të pakicave në zgjedhjen e udhëheqësisë së shkollave (Albanci u Srbiji, 13).

Në botimin e Fondit për të Drejtën Humanitare theksohet se planet dhe programet mësimore janë çështje vendimtare në arsimin e të gjitha pakicave në Jugosllavi. „Ky problem nuk është zgjidhur në mënyrë të duhur as për pakicën shqiptare. Nxënësit ende në mësim në gjuhën shqipe mësojnë sipas planeve dhe programeve të aprovuara në vitin 1989. Librat shkollore vetëm janë përkthyer në gjuhën shqipe, por nuk janë plotësuar me njësi mësimore përkatëse që do të merreshin me kulturën dhe historinë kombëtare“ (po aty, 76).

Vetëm pas ndryshimeve demokratike në Serbi ka qenë e mundur të bisedohet për problemet lidhur me arsimin e pakicës kombëtare në jug të Serbisë. Fondi për të Drejtën Humanitare thekson se atëherë përfaqësuesit shqiptarë disa herë i kanë paraqitur propozimet për përmirësimin e gjendjes. Ata kanë kërkuar që shqiptarët të marrin pjesë në udhëheqjen e shkollave, që me ligj të mundësohet themelimi i shkollave fillore dhe të mesme me plane dhe programe të ndara arsimore dhe me libra shkollore në gjuhën shqipe, pastaj themelimi i Komitetit të veçantë arsimor (Serbia-Kosova) me të cilin do të rregulloheshin çështjet e shkollimit të shqiptarëve nga kjo trevë në shkolla të mesme të cilat nuk ekzistojnë në Luginën e Preshevës dhe në shkollat e larta dhe në universitete në Kosovë, njohja e të gjitha diplomave të fituara në shkolla të larta dhe të mesme në Kosovë dhe në Universitetin e Prishtinës në periudhën 1991-2001, përsheptimi i procedurës së nostrifikimit të diplomave nga Universitetet e Shqipërisë dhe në shtete të tjera, ndërtimi i rikonstruktimit të objekteve shkollore dhe sigurimi i pajisjes për modernizimin e procesit mësimor (po aty, 71).

Dalja e nxënësve dhe arsimtarëve shqiptarë në Kosovë nga sistemi unik arsimor i Serbisë është manifestuar edhe te pjesatarët e bashkësisë etnike shqiptare në jug të Serbisë. Për shkak të programeve joadekuate mësimore në ambientin e vet rrethues, mungesa e institucioneve arsimore në gjuhë amtare, sidomos për shkak të shndërrimit të gjimnazit të Bujanocit në kazermë, një numër i shqiptarëve nga këto komuna arsimin fillor dhe të mesëm e ka kryer në Kosovë, kurse një numër më i madh i atyre arsimin e lartë e kanë kryer në Universitetin e Prishtinës dhe të Tiranës.

Diplomat e fituara në shkollat alternative shqiptare në Kosovë pas vitit 1991 kanë pasur shenjën „Republika e Kosovës“. Këto diploma Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë nuk i ka pranuar si të vlefshme. Pushteti demokratik ka treguar gatishmëri për ta zgjidhur këtë problem. Ministria e Arsimit dhe e Sportit, më 4 maj të vitit 2003 ka dhënë mendimin sipas të cilit „të gjitha diplomat e lëshuara në territorin e Republikës së Serbisë dhe të RFJ kanë kalueshmëri të drejtpërdrejtë në të gjitha pjesët e territorit, përkatësisht nuk i nënshtrohen procedurës së nostrifikimit. Kjo që është theksuar më lart vlen edhe për territorin e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit“ (po aty, 75).

Lidhur me diplomat e fituara në Shqipëri, Ministria është e mendimit që secili person „ka të drejtë të kërkojë nostrifikimin ose njohjen e ekuivalencës“. Në parashtrësën e Këshillit për të Drejta të Njeriut nga Bujanoci më 20 shtator të vitit 2003, Ministria është përgjigjur që „*kjo ministri për shkaqe të arsyeshme nuk mund ta pranojë asnjë diplomë, e cila është lëshuar me shenjën Kosova Republikë. Mirëpo, të gjitha diplomat të cilat do të noterizohen me vulë të UNMIK-ut, përveç atyre që e mbajnë shenjën Kosova Republikë, do të pranohen nga ana e kësaj ministrie*“ (po aty, 76).

Në nëntor të vitit 2011, gjatë dialogut teknik midis Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel për normalizimin e marrëdhënieve, u morr vendimi për njohjen e diplomave nga Kosova në Serbi. Është dakorduar reciprociteti, kështu që edhe në Beograd edhe në Prishtinë të miratohen dokumentet të cilat do ta rregullojnë këtë fushë, gjë që edhe është bërë në vitin 2012. Mirëpo, Gjykata Kushtetuese e Serbisë e shpalli jokushtetuese urdhëresën, të cilën e ka miratuar Qeveria e Serbisë në prill të vitit 2014, por ky vendim u publikua me një vonesë prej gjashtë muajsh. Ndërkohë, me ndryshimet e Ligjit për arsimin e lartë, të cilin e ka propozuar ministria e Arsimit, kurse e ka aprovuar Kuvendi i Serbisë, është parashikuar që Qeveria mund ta marrë një urdhëresë të tillë. Urdhëresa e re nuk ka risi të veçanta në krahasim me të vjetrën, por bazohet në Ligj (*Odluka o neustavnosti diploma ozbiljan test, 2014*).

Kriminologu i diplomuar Besfort Jonuzi, i cili diplomën e ka marrë në Prishtinë edhe pas peripecive të mëdha ka arritur ta nostrifikojë diplomën e vet në Serbi, ka deklaruar për Radio Evropën e Lirë: „Nuk dua të besoj se ekziston ndonjë diskriminim për shkak se jam shqiptar. Kur kemi dëgjuar për marrëveshjen për njohjen e diplomave të Kosovës natyrisht që kemi shpresuar se këto probleme do të zgjidhen dhe që do ta tejkalojmë këtë situatë. Por tani, natyrisht, ky është një hap prapa për ardhmërinë tonë, sepse tepër shumë jemi të përqendruar të studiojmë në Kosovë për shkak të afrisë dhe për shkak të gjuhës. Të rinjve sot fare nuk u interesojnë këto probleme politike, ata vetëm janë të interesuar të merren me punët për të cilat i kanë mbaruar studimet dhe të kontribuojnë që shoqëria jonë të shkojë përpara ” (po aty).

Problemet lidhur me programet mësimore dhe me librat shkollorë

Kryetari i Komunës së Preshevës Riza Halimi, në tetor të vitit 2002 ka deklaruar se degradimi i sistemit arsmor në atë trevë ka filluar në vitin shkollor 1983/84, kur pushteti arsimor i Serbisë e ka ndaluar përdorimin e librave shkollorë dhe të doracakëve të cilët janë shtypur në Prishtinë. Në mënyrë arbitrare është vendosur mësimi eksperimental në baza të përbashkëta të përgatitjes dhe të planifikimit për tërë Jugosllavinë, por të cilin asnjë republikë nuk e ka aplikuar në praktikë. Në programin e atij mësimi ka qenë e eliminuar kultura dhe historia e shqiptarëve (Halimi, 2002).

Në fillim të viteve 90-të, në atë trevë janë dërguar librat shkollorë dhe doracakët të cilët Enti për Libra Shkollorë në Beograd i ka përkthyer nga gjuha serbe. Shumica e tyre nuk e ka përmbajtur ndonjë lëndë përkatëse për mësimin në gjuhën shqipe dhe në to ka pasur mjaft gabime gjuhësore dhe materiale. Një praktikë e tillë është

ndërprerë në vitin 1998/99, por mësimi në gjuhën shqipe edhe më tutje është mbajtur pa libra shkollorë dhe pa doracakë. Janë fotokopjuar librat shkollorë të botimeve të mëparshme. Ministria e Arsimit e Serbisë nuk i ka pranuar propozimet që bashkësia vendore t'i formojë këshillat e shkollave, por për një kohë të gjatë ka mbajtur këshillat e formuara më parë të zgjedhura në mënyrë arbitrare (po aty).

Sipas hulumtimit të Fondit për të Drejtën Humanitare në Beograd, gjendja në arsimin e shqiptarëve në gjuhën shqipe gjatë dhjetëvjetëshit të fundit të shek. XX ka qenë e ngjashme me gjendjen në arsimin e pakicave të tjera kombëtare në Serbi. Si shkak për këtë theksohen „programet shkollore etnocentrike, përmbajtjet ofenduese të librave shkollorë dhe centralizimi i plotë në vendim-marrje [që] ende gjithnjë po e vështirësojnë arsimin adekuat në gjuhën shqipe“ (Albanci u Srbiji, 6).

Në fund të viteve të 80-të dhe gjatë viteve 90-të, masat e dhunshme të cilat janë ndërmarrë në shkolla në gjuhën shqipe në jug të Serbisë, seriozisht e kanë ndaluar zhvillimin e mësimin. Në atë periudhë madje është kërkuar korrigjimi dhe ndryshimi i emërtimeve të disa shkollave. Me vendim të Sekretariatit për çështje administrative dhe të tjera të KK në Medvegje më 8 dhjetor të vitit 1988, në Tupallë, emërtimi i shkollës fillore „Zenel Hajdini“ duhet të ndërrohet në „Zeinel Ajdinoviq“, siç ishte regjistruar në dokumente personale ky hero i popullit gjatë Mbretërisë së Jugosllavisë, në të cilën, siç dihet, mbiemrat e shqiptarëve serbizoheshin me mbaresën „viq“ (Muharremi, 2010, 343). Mësimi në gjuhën shqipe i cili është vendosur në vitin 1978-79 në dy paralele në shkollën e mesme teknike „Nikola Tesla“ në Medvegje, është ndërprerë gjatë vitit 1987-88, kur arsimtarët dhe nxënësit i refuzuan masat e ndërmarra për ndryshimin e programit të mësimin. Mësimi në atë shkollë në gjuhën shqipe ka vazhduar 17 vjet më vonë në vitin shkollor 2005-2006. (po aty, 330, 335).

Hap pozitiv është bërë në vitin 2006, kur gjimnazit në Preshevë i është kthyer emërtimi „Skënderbeu“, ashtu siç është quajtur nga viti 1968 deri në vitin 1989, kur iu ndryshua emri në „25 Maj“. Ky gjimnaz është krijuar nga paralelet në gjuhën shqipe të cilat janë hapur në vitin shkollor 1960/1962 në gjimnazin „Bora Stankoviq“. Emërtimi i parë i gjimnazit në vitin 1964/65 ka qenë „Agimi i socializimit“ dhe provimin e maturës e kanë dhënë 52 nxënës të kombësisë shqiptare, të cilët e kanë ndjekur mësimin në gjimnazin „Bora Stankoviq“. Gjimnazi në vitin 1968 e ndryshoi emërtimin në „Skënderbeu“.

Pika më e dhembshme në mësimin në gjuhën shqipe në shkolla fillore dhe të mesme janë librat shkollorë, sepse nxënësit deri në vitin shkollor 2005/2006 kanë përdorur librat shkollorë dhe doracakët e destinuar për nxënësit e kombësisë serbe, të cilët janë përkthyer me shumë gabime. Përdorimi i tyre ka qenë imponim i kulturës dhe i traditës serbe nxënësve të pakicës kombëtare shqiptare. Në raportin e Rrjetit të Këshillit për të Drejta të Njeriut në Serbi (CHRIS) nga viti 2007, thuhet se në komunën e Preshevës, Buajnocit dhe të Medvegjës janë formuar grupet e punonjësve të arsimit të kombësisë shqiptare, të cilët kanë punuar në hartimin e planeve edhe të programeve për lëndët: gjuhë dhe letërsi shqipe, histori, kulturë muzikore, gjeografi, art figurativ. Në bazë të propozimeve të tyre, deri më tani është ndryshuar plani dhe programi për

gjuhë dhe letërsi shqipe nga klasa I deri në klasën VIII të shkollës fillore (me përjashtim për klasën e III)), por për shkak të reagimeve të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit nuk janë bërë kurrfarë ndryshimesh në lëndën e historisë, kulturës muzikore, artit figurativ dhe gjeografisë. Ato kanë mbetur të pandryshuara që nga viti 1983 dhe sipas tyre nxënësit e pakicës kombëtare shqiptare mësojnë dhe e kultivojnë shumë më tepër kulturën dhe traditën serbe se sa të veten. Për shembull, libri i kulturës muzikore nga klasa e I deri në klasën e VI i shkollës fillore përmban 139 vjersha në gjuhën serbe dhe vetëm tri në gjuhën shqipe.

Gjithashtu në shkolla të mesme nuk ka ndryshim të planeve dhe të programeve për gjuhë shqipe për lëndën gjuhë dhe letërsi shqipe, histori, kulturë muzikore dhe art figurativ. Ato nuk kanë pësuar kurrfarë ndryshimesh nga viti 1983. „Nxënësit shqiptarë sot më shumë e mësojnë letërsinë serbe se sa të veten, meqenëse e mësojnë nga lënda e gjuhës serbe si lëndë joamtare (2-3 orë në javë) dhe nga lënda gjuhë shqipe (në formë të përkthimit të veprave serbe). Lektyra shkollore në gjuhë shqipe përmban 50% veprave të letërsisë shqipe dhe 50% të letërsisë serbe“ (Mreža odbora, 2007, 59). Gjithashtu në raport pohohet se në Preshevë në gjuhën shqipe është organizuar dhënia e provimit profesional për arsimtarë vetëm për lëndën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Për lëndë të tjera mësimore, dhënia e provimit ka qenë vetëm në gjuhën serbe (në Nish dhe në Beograd), gjë që në pikëpamje të terminologjisë është problem për arsimtarët shqiptarë, sepse shkollat i kanë mbaruar në gjuhën shqipe (po aty).

Organizata joqeveritare Nisma e të Rinjve për të Drejta të Njeriut i ka dërguar një Apel Ministrisë së Arsimit të Serbisë më 3 shtator të vitit 2012 që të nisë zgjidhjen e vazhdueshme të problemeve të mungesës gati të plotë të librave shkollorë në gjuhën shqipe për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në komunën e Bujanocit dhe të Preshevës. Në këtë Apel thuhet: „Përderisa ditëve të fundit po arrijnë informatat për librat shkollorë falas në gjuhën serbe për nxënës nga klasa I deri në klasën e IV të shkollave fillore në territorin e Serbisë, librat shkollorë falas dhe pajisjet shkollore për nxënësit e klasës së parë në Beograd (...) në Bujanoc në gjashtë shkolla fillore dhe një të mesme, më shumë se 6000 nxënës më 3 shtator janë nisur në orë të mësimi gati pa asnjë libër shkollor që u përgjigjet standardeve dhe programeve të cilat aplikohen në shkollat e tjera në Serbi. E njëjta situatë është edhe në tetë shkolla fillore dhe dy të mesme në Preshevë, në të cilat shkollohen më shumë se 7000 nxënës.“ Gjithashtu në Apel pohohet se në vitin e mëparshëm shkollor, i vetmi libër shkollor në gjuhën amtare të cilin e kanë pasur nxënësit e klasës së parë në jug të Serbisë ka qenë *Abetarja*, kurse nxënësit e klasëve të tjera, përveç librit shkollor për gjuhë, nuk kanë pasur asnjë libër tjetër në gjuhë të vet. Sipas të dhënave të Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Serbi, për zhvillimin e papenguar të mësimi nevojiten edhe 100 libra shkollorë për shkolla fillore dhe afro 400 për shkolla të mesme të të gjitha profileve.

Në Apel pohohen fjalët e një nxënëseje të klasës së 4-të të gjimnazit „Skënderbeu“ nga Presheva: „Unë i marr librat nga nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën para meje dhe këta libra zakonisht janë libra shumë të vjetër, që nga koha kur i kemi siguruar në Kosovë. I marrim hua nga fëmijët nga paralelet e tjera të cilët kanë gjetur mënyrë

dhe i kanë blerë librat në Shqipëri. Ua marr shokëve librat dhe kur mbaron mësimi ua kthej“. Ajo pohon që kryesisht të gjithë nxënësit i kanë librat për lëndët e gjuhëve (për shqip, serbisht, anglisht, frëngjisht) të shtypura në Serbi, por që nxënësit nga shkolla e saj shpesh po ballafaqohen edhe me problemet sepse librat shkollorë të cilët i marrin nga gjeneratat e mëparshme nuk mund t'i përdorin sepse programet në ndërkohë janë vjetëruar. Përveç kësaj, Nisma e të Rinjve për të Drejta të Njeriut bën me dije se arsimit në gjuhët e pakicave në Vojvodinë po funksionon pa probleme të mëdha, ku mësimi zhvillohet në gjashtë gjuhë, bashkë me mundësinë e punës edukativo-arsimore në dy gjuhë me fëmijë të moshës parashkollore (Iniciativa mladih, 2012).

Në jug të Serbisë (në Luginën e Preshevës), sipas marrëveshjes së Ministrisë së Arsimit të Serbisë dhe Këshillit Kombëtar të Pakicës Kombëtare Shqiptare në Serbi, nga viti 2010 ka filluar të botohen librat shkollorë për mësim në gjuhën shqipe për shkolla fillore. Shumica e këtyre librave shkollorë është përkthyer nga gjuha serbe. Deri në vitin 2014 janë botuar 88 libra shkollorë dhe fletore të punës, nga të cilët tetë libra i kanë shkruar autorët shqiptarë të vendit, për matematikë nga klasa 1 deri në klasën 4, tre libra shkollorë për fëmijë të moshës parashkollore, kurse 16 libra sipas marrëveshjes janë importuar nga Shqipëria, në mesin e të cilëve edhe *Abetarja* e cila është rishtypur me korrigjime shumë të vogla me motive politike. Për shkolla të mesme nuk është shtypur asnjë libër shkollor sepse nuk e ka marrë pëlqimin paraprak të Këshillit Kombëtar të Pakicës Kombëtare të Shqiptarëve. Shumicën e librave shkollorë i kanë shtypur botuesit e licencuar të Beogradit: Enti për Botimin e Teksteve, Klett dhe Kreativni centar.¹³⁵

Kur është fjala për *Abetare* të cilën e ka rishtypur shtëpia botuese e licencuar e Beogradit Klett, kjo është bërë pasi ky libër më parë është importuar në mënyrë ilegale dhe është përdorur në mësim pa leje të Ministrisë për Arsim të Serbisë. Më vonë, Ministria për Arsim e Serbisë dhe Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve në Serbi, me ndërmjetësimin e ambasadorit të Shqipërisë në Beograd, Shpëtim Çaushtit, kanë rënë dakord që të importohet *Abetarja*, por të bëhen disa korrigjime. Te shkronja e gjuhës shqipe SH, në vend të fotografisë së Shkodrës me legjendën „Shkodra është qytet i bukur, në botimin e parë të rishtypur është bërë ndryshimi „Nishi është qytet i bukur, kurse në botimin e 2-të dhe të 3-të: „Presheva është qytet e bukur“, me ç'rast është dhënë gabim gjinia e mbiemrit i bukur/e bukur gjë që është gabim i palejueshëm gramatikor në gjuhën shqipe. Te shkronja F, në fjalën „Flamuri“, është hequr fotografia e flamurit kombëtar shqiptar dhe marrëzisht është lënë fusha e zbrazët në të cilën nxënësit, sipas rregullit, e vizatojnë flamurin e kombit shqiptar, gjë që është „rikorrigjim“. Nëse i përjashtojmë edhe disa ndryshime të emërtimeve të qyteteve, çdo gjë tjetër ka mbetur si edhe në origjinal të kësaj abetareje (Gjokutaj, Rrokaj, 2010, 49, 52).

¹³⁵ Të dhënat janë marrë nga këshilltarja e drejtoreshës së Shërbimit të Trupit koordinues Milica Rodiqit, e ngarkuar për punë në fushën e përparimit të cilësisë së arsimit për nxënësit të bashkësisë kombëtare shqiptare në jug të Serbisë.

Me këta libra shkollorë mbulohet pjesa më e madhe e mësimin në gjuhën shqipe në shkolla fillore në atë trevë. Në vitin shkollor 2014/2015 në këto shkolla kanë qenë gjithsej 3522 nxënës në 16 shkolla fillore: në shtatë shkolla në Preshevë (204 paralele, 3599 nxënës, në vitin e mëparshëm shkollor 3905 nxënës), gjashtë në Bujanoc (në 144 paralele, 2304 nxënës, në vitin e mëparshëm shkollor 2516) dhe tri në Medvegjë (në 18 paralele, 61 nxënës, gjatë vitit të mëparshëm shkollor 55). Tri shkolla fillore janë shumëetnike dhe këtë; një në fshatin Relan, në komunën e Preshevës, një në Jabllanicë të Epërme, në Banjën e Sjarinës dhe një në Komunën e Medvegjës. Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkolla fillore në gjuhën shqipe ka qenë 5964. Shkolla të mesme në atë trevë janë gjithsej katër: në Preshevë një gjimnaz (204 paralele, 3599 nxënës dhe një shkollë teknike (79 paralele, 2222 nxënës), në Bujanoc një gjimnaz (49 paralele, 1333 nxënës) dhe në Medvegjë një shkollë teknike me nxënës të dy kombësive (katër paralele, 29 nxënës). Gjithsej nxënës në shkolla të mesme në gjuhën shqipe kanë qenë 3584.

Qeveria e Vojvodinës më 19 tetor të vitit 2011 ka marrë vendimin që nga buxheti krahinor të financojë regjistrimin në vitin e parë të studimeve 60 studentë të kombësisë shqiptare, të cilët do të studiojnë në Bujanoc, ku gjendet Fakulteti Ekonomik nga Subotica, si pjesë e Universitetit të Novi Sadit, i hapur si një paralele e jashtme. Anëtarët e qeverisë krahinore me këtë rast kanë konstatuar që vendimi është, nga njëra anë, mirënjohje e veçantë për Universitetin e Novi Sadit, kurse nga ana tjetër është kontribut për stabilizimin e rrethanave në atë pjesë të Serbisë, siç pohohet në kumtesën e Sekretariatit Krahinor për Kulturë dhe Informim Publik (Tanjug, 2011). Fjala është për studimet nga fusha e marketingut, kurse mësimi do të zhvillohet në dy gjuhë. Profesorët e Fakultetit Ekonomik nga Subotica do të mbajnë ligjërata në gjuhën serbe, kurse mësimin në gjuhën shqipe do ta mbajnë profesorët e Universitetit të Tetovës (Maqedoni) me titull profesorë të ftuar të Universitetit në Novi Sad. Për nevoja të mësimin në gjuhën shqipe në periudhën 2010-2014 janë shtypur mbi 50 libra shkollorë universitarë të cilët janë përkthyer nga gjuha serbe dhe këtë në botim të Trupit koordinues të Qeverisë së Serbisë për komunën e Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës.

Përfundim

Ky punim merret me implikimet politike të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e arsimit në Kosovë dhe në jug të Serbisë (1945-2015). Arsimi në ato dy treva ka filluar të zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, gjë që ka qenë hap i madh qytetërimi për popullsinë shqiptare në ato zona. Në pikëpamje të numrit të nxënësve dhe paraleleve, zhvillimi ka qenë progresiv gjatë viteve 80-të. Në pikëpamje të programit shkollor, deri në vitet 60-të ka qenë i reduktuar në aspektin ideologjik dhe politik lidhur me disa ngjarje dhe personalitete të veçanta historike dhe politike, për të përmendur shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare shqiptare në shek. XIX. Ndryshimi pozitiv u krijua në mes të viteve të 60-të kur një numër i rëndësishëm i shkrimtarëve ka hyrë në program për mësim dhe më gjerësisht është përfshirë historia

e popullit shqiptar. Librat shkollorë të cilat janë shtypur sipas programit të atëhershëm të Sekretariatit për Arsim të Krahinës Autonome të Kosovës janë përdorur, sipas automatizmit, edhe në jug të Serbisë.

Fillimi i krizës së thellë politike në Kosovë u manifestua menjëherë negativisht edhe në programe mësimore në shkolla fillore, të cilat Ministria e Arsimit e Serbisë ka dashur t'i reduktojë dhe t'i korrigjojë në mënyrë drastike, sidomos lëndën e historisë dhe të gjeografisë, njohuri natyre dhe madje edhe edukatën muzikore. Kjo ka pasur si pasojë daljen demonstrative të shkollave në gjuhën shqipe, në Kosovë, nga sistemi arsimor i Republikës së Serbisë gjatë viteve 90-të. Në të njëjtën kohë, në jug të Serbisë në programet e mësimi janë vendosur shumë kufizime. Në shkollat në Luginë nuk kanë guxuar më t'i përdorin as librat e rinj as të vjetër shkollorë, të cilët janë shtypur në Kosovë. Librat e rinj shkollorë, të cilët janë përkthyer nga serbishtja dhe janë shtypur në Beograd, në Entin për Botimin e Teksteve, punëtorët shqiptarë të arsimit i kanë injoruar.

Arsimi në Kosovë është stabilizuar pas ndërhyrjes së Aleancës së NATO-s dhe miratimit të Rezolutës 1244 më 10 qershor të vitit 1999 në Këshillin e Sigurimit të OKB, me të cilën në Kosovë është vendosur sovraniteti i brendshëm. Në jug të Serbisë, ndryshime pozitive kanë filluar të paraqiten që nga viti 2010 kur ministria e Arsimit e Serbisë, me pëlqimin paraprak të Këshillit Kombëtar të Pakicës Kombëtare në Serbi, ka filluar të miratojë botimin e një numri të librave shkollorë. Problem politik edhe më tutje ka mbetur botimi i librave shkollorë për shkolla fillore për lëndët *Natyra dhe shoqëria* për klasën e 4-të, Historia për klasën e 5,6,7,8, Historia për klasën e 1,2,3,4 të gjimnazit, Historia për klasën 1-rë dhe të 2-të të shkollave të mesme profesionale, Gjeografia për të gjitha klasat e shkollave fillore, gjimnazin dhe shkollës së mesme profesionale. Problem i ndjeshëm sidomos ka mbetur mungesa e librave shkollorë për shkolla të mesme.

Zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe në Kosovë në të gjitha nivelet dhe në jug të Serbisë (në Luginën e Preshevës), edhe përkundër kufizimeve ideologjike dhe politike, në Jugosllavinë socialiste ka pasur rezultate të dukshme në shkollimin e gjeneratave të shumta të kombësisë shqiptare, në formimin dhe aftësimin e tyre profesional. Fatkeqësisht, për shkak të çrregullimeve politike gjatë viteve 80-të dhe 90-të të shek. XX, janë krijuar kushte mjaft të vështira për mbajtjen e mësimi në gjuhën shqipe në ato treva. Kjo në Kosovë ka zgjatur deri në qershor të vitit 1999, kur ajo u nda nga sistemi politik i Serbisë. Në jug të Serbisë, në pikëpamje të programeve dhe teksteve shkollorë, arsimit edhe më tutje është nën presionin e fuqishëm të Ministrisë së Arsimit në Beograd. Kjo gjë ka si pasojë improvizimin e mësimi, ku çdo gjë varet nga shkathtësia *ad hoc* e arsimtarëve dhe e nxënësve. Me ndryshimin cilësor të situatës në vitin 2010, punëtorëve të arsimit të asaj treve u është mundur që t'i hartojnë programet e mësimi për nxënësit e shkollave të mesme në gjuhën shqipe, si edhe t'i zgjedhin librat shkollorë të autorëve shqiptarë të vendit, të autorëve nga Shqipëria ose autorëve të cilët janë përkthyer nga gjuha serbe. Kjo në një masë të konsiderueshme e ka përmirësuar zhvillimin e mësimi në gjuhën shqipe në atë trevë, me tendencë të përparimit të përhershëm.

Literatura:

ALBANCI u Srbiji (2003), Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, Beograd: Fond za Humanitarno pravo.

BEQAJ, N. (1988), Politička iskušnja inteligencije na Kosovu, *Pogledi*, Split, 18, 2.

BERISHA, T. Z. (1994) *Emra që nuk harrohen: Arsimtarët veteranë (1941-1951) dhe Arsimi shqip në Kosovë*. Prishtinë : Valton.

DISKRIMINACIJA na jugu Srbije, Inicijativa mladih za ljudska prava, *Peščanik*. Gjetet në: <http://pescanik.net/diskriminacija-na-jugu-srbije> [e parë më: 03.09.2012]

EMINI, A. (2014) *Presheva në rrjedhat e historisë shek. XX*. (Disertacion doktorate). Universiteti i Tiranës, Fakulteti historio-filogji, Departamenti i historisë, Tiranë.

Etnike zajednice, 2007, 2008, *Etnike zajednica na Kosovu u 2007. i 2008*. Fond za humanitarno pravo. Gjetet në:<http://www.hlc-rdc.org/?p=13188> [e parë më: 11.08.2010]

GJOKUTAJ, M., RROKAJ, Sh. (2010) *Abetare : Shkronja pas shkronja*, Beograd: Klett.

GOJKOVIĆ, N., *Sistem zaštite manjina u Republici Srbiji*. Konrad Adenauer Stiftung. Gjetet në: http://www.kas.de/upload/auslandshomepages/serbien/Gojkovic_pred.pdf [e parë më 30.01.2008]

HYSENI, H., (2000) *Shifra dhe fakte për arsimin në Kosovë*. Prishtinë. Gjetet në: http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/edu_kos_p0-108-yug-kos-aln-t01.pdf [e parë më: 30.01.2010]

IMAMI, P. (2000), *Srbi i Albanci kroz vekove*. Beograd: K.V.S.

Kosovo nekad i danas / Kosova dikur e sot. (1973) Beograd: Ekonomska politika.

Ligji nr. 2002/2 mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë = Zakon br. 2002/2 o osnovnom i srednjem obrazovanju na Kosovu/. Gjetet në:

http://www.masht-gov.net/advCms/documents/1_RREG_LIGJI_SHQIP_Nr.20022.pdf [marrë më: 30.01.2010]

MREŽA odbora za ljudska prava u Srbiji (CHRIS), Izveštaj koji se podnosi na osnovu Člana 25, paragraf Okvirne konvencije za zaštitu nacionalnih manjina, Septembar 2007, str. 59-60. Marr në: <http://chris-network.org/wp-content/uploads/2009/12/Drugo-Mi%C5%A1ljenje.pdf> [e parë më më 30.11.2014] Raporti i cili paraqitet në bazë të nenit 25, paragrafi i Konventës orientuese për mbrojtjen e pakicave kombëare, Shtator 2007, fq. 59/60

MUHARREMI, I. (2010) *Shqiptarët e Medvegjës nëpër shekujt*, Prishtinë.

ODLUKA o neustavnosti diploma ozbiljan test. *Radio Slobodna Evropa*. Gjetet në: www.slobodnaevropa.org, [e parë më 08.05.2014]

PROBLEMET AKTUALE, *Problemet aktuale ne sferën e arsimit*, fjala hyrëse e Riza Halimit, kryetar i komunës, në seancën e IB të Kuvendit Komunal të Komunës së Preshevës. Gjetet në: <http://www.presheva.com/arsimi/problemetarsimihyrese231002.html> [e parë më 30.01.2010]

STOJKOVIĆ L.J., MARTIĆ M. (1953) *Nacionalne manjine u Jugoslaviji*, Beograd: Rad. STATISTIČKI godišnjak Srbije, 1986, 1995, *Statistički godišnjak Srbije*, Beograd: Republički zavod za statistiku Srbije.

STATISTIKAT e arsimi 2013-1024. *Agjencia e statistikave të Kosovës*, <http://ask.rks-gov.net/arsimi/publikimet> [e parë: 29.12.2014]

Sukob ili dijalog, 1994, *Sukob ili dijalog : Srpsko-albanski odnosi i integracija Balkana*. Subotica.

TEMTATSKI izveštaj, 2001, *Tematski izveštaji nacionalnoj obrazovnoj politici – Kosovo*. Pakt o stabilnosti za Jugoistočnu Evropu, 22. jun 2001, prevela Fadila Kajević. Gjendet në: http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/thematic-review-yug-kos-srb-t05.pdf [e parë më më 30.01.2010] Originali: *Thematic Review Of National Policies For Education – Kosovo*. 22-Jun-2001. Pact for South Eastern Europe:

[http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=CCNM/DEELSA/ED\(2001\)6&docLanguage=En](http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?cote=CCNM/DEELSA/ED(2001)6&docLanguage=En)

ZAKON o ratifikaciji, Zakon o ratifikaciji evropske povelje o regionalnim ili manjinskim jezicima, *Službeni list SCG - Međunarodni ugovori*, br. 18/2005. Ligji për ratifikim, Ligji për ratifikim i Kartës Evropiane për gjuhët rajonale ose gjuhët e pakicave Fletorja zyrtare e SMT – Kontratit ndërkombëtare, nr. 18/2005.

Naile Mala-Imami
Faculty of Philology
University of Belgrade

Education system in Albanian language in Kosova/o and south of Serbia (1945-2015)

Abstract:

Purpose of this paper is to provide historical overview of the development of school system in Albanian language from 1945 to 2015 in Kosovo and South of Serbia, in municipalities of Presheva, Bujanovac and Medvedja. After the Second World War and establishment of socialist socio-economic relations, historical injustice against the Albanian people who did not have the right for education in their mother tongue during the Kingdom of Serbs Croats and Slovenians has been corrected. Year after year, despite numerous problems, education in Albanian language was spread systematically in primary and secondary education system while in 1960 foundations for university studies were laid down. Development in school system in Albanian language in Kosovo at all levels by 1990, despite ideological and political constraints, has had tangible results in the education of many generations of Albanians. After 1999 Kosovo has developed an independent education system while Albanians from South of Serbia partially exercise the right to treat some of topics that relate to their nation.

Key words:

School system in Albanian, Kosovo, South of Serbia, Serbia, Educational policy

